



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 260, dt. 13.12.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.12.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Mirëmbajtje dhe restaurime në Qendrën Historike të Qytetit të Beratit", hartuar nga DRKK Berat për objektet si më poshtë:
 - Restaurim dritaresh në banesën e Z. Vasillaq Gjogu Lagjja "Mangalem" (M -006);
 - Restaurimi i fasadës së banesës së z. Xhovan Koxhaku, Lagjja "Mangalem" (M-018).
 - Restaurim i portës dhe muraturës mbajtëse në banesën e znj. Margarita Kalldrëmxiu, Lagjja "Mangalem" (M-081/1).
2. Nuk miratohen objektet si më poshtë:
 - Strehë porte në banesën e Z. Ismet Hundo, Lagjja "Mangalem" (M – 124);
 - Ndërtim çati porte në banesën e Znj. Fatbardha Kodheli, Lagjja "Mangalem" (M -122).
 - Strehë porte në banesën e Z. Polizoi Niko, Lagjja "Mangalem" (M -131).
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI